

## INTERVISTË ME İSKENDER MUZBEG

Prizren | Data: 25 janar, 2022

Kohëzgjatja: 63 Minuta

Të pranishëm:

- İskender Muzbeg (I intervistuari)
- Anita Susuri (Intervistuesja)
- Renea Begolli (Kamera)

*Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:*

*() - komunikim emocional*

*{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste*

*Simbole të tjera në transkriptë:*

*[ ] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin*

*Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.*

## Pjesa e Parë

**Anita Susuri:** Zotëri Iskender prezantone veten, në cilin vit jeni lindur, fëmijërinë si e keni kaluar?

**Iskender Muzbeg:** Ju faleminderit, fillimisht dua të ju falenderohem edhe një herë që jeni interesuar për mua. Unë jam lindur në muajin dhjetor të vitit 1947 në Prizren. Pastaj, pasi që jam rritur e kam kuptuar se këto vite paskan qenë mjaft të vështira. Kishte njerëz që ishin madje në prag të urisë. Familja jonë ka qenë një familje mesatare. Babai im që në kohën e osmanëve e kishte përfunduar *Rüştiyen*<sup>1</sup>. Ndërmjet dy luftërave botërore, nëpër fshatra të ndryshme të Kosovës, ka punuar si hoxhë gjatë Ramazanit. Unë kam ardhur në jetë nga martesë e tretë e babait tim. Kur unë jam lindur, domethënë në vitin 1947 babai im ka qenë 55 vjeçar. Sigurisht që vitet e fëmijërisë sime kaluan me vështirësi dhe në atë kohë në Kosovë, ashtu edhe në Prizren, përgjithësisht njerëzit kalonin situata mjaft të vështira.

Më kujtohet një tregim, [lidhur me] sandalet. Më kujtohet që në një ditë vjeshte unë me sandale, domethënë jo me këpucë por sandale, me sandale shkoj në shkollë dhe gjatë pushimit duke luajtur një sandale mu këput përgjysmë. Jam kthyer në shtëpi, për t'i ndërruar por nuk kisha sandale tjera që t'i ndërroja dhe i kam veshur çizmet e mëdha të motrës sime dhe ashtu duke u turpëruar me ato çizme të mëdha kam shkuar në shkollë. Pra, fëmijëria më ka kaluar me mjaft vështirësi. Në klasë të parë... unë jam lindur në Terzi mahallë [Lagjja e terzinjëve]. Në lagjen Terzi mahalla të Prizrenit. Në atë kohë Prizreni edhe ashtu ishte shumë i vogël. Shkoje deri në Jeni mahallë [lagjja e Re] pas asaj vetëm bahçe, ka pasur bahçe. Tani Jeni mahalla konsiderohet si qendër e Prizrenit. Në këtë Terzi mahallë ka qenë një shkollë e vogël dy katëshe. Në pjesën e Hoçës të lagjes Terzi.

Babai më regjistroi në atë shkollë, e mbaj mend mirë dhe mësuesi im i parë ishte Sherif Kaçaniku. Ishte viti shkollor 1955-56. E në atë kohë kishte nxënës shumë por libra nuk kishte. Nuk kishte libra shkollor, abetare. Më duket që kanë kaluar diku dy-tre muaj, pastaj mësuesi Sherif na dha neve një fletore në të cilën kishte shkruar me laps të zi. Në atë fletore e kishte kopjuar një alfabet. Teksti për shkronjën A për shkronjën B, e kështu me radhë. Prandaj edhe tani e kujtoj me respekt mësuesin Sherif. Na ka mësuar

<sup>1</sup> Turk.: *Rüşdiye* është një institucion arsimor i mesëm i hapur në kohën e Perandorisë Osmane pas Ediktit të Tanzimatit të shpallur në vitin 1839.

në klasën e parë dhe kur shkuam në klasën e dytë, Sherif Kaçaniku ndërroi jetë në moshë të re. Një mësues i ri na erdhi në klasën e dytë.

Dua të flas pak për mësuesit sepse nëse mund të flas diçka sot, ua kam borxh atyre. Në klasën e dytë erdhi një mësues me emrin Fehmi Dervishi. Edhe ai një vit na ka mësuar dhe është larguar për një mision tjetër. Pastaj, Abdul Bahri Hafizi, mësuesi ynë i klasës së tretë që ishte shumë zotëri, vishej shumë [bukur] por prej neve kërkonte shumë, kriteret i kishte shumë të larta dhe në klasë të tretë askush nuk kaloi me pesa. Madje edhe nxënësit më të mirë kalonin me katërshe. Dhe në klasë të katërt prapë një mësues që unë e doja shumë Subi Pasuli, ai mbajti edhe poste të tjera më vonë. Është bërë drejtor i ndërmarrjes “Famipa” e tjerë. Natyrisht, mësimet kemi marrë edhe nga Subi Pasuli. Kështu më kanë kaluar mua katër vite në atë shkollë fillore.

Pastaj në tjetër, në shkollë të njejtë “Mustafa Bakia” por tjetër objekt, tjetër vend, në klasë të pestë dhe të gjashtë kam shkuar atje dhe në klasë të pestë ka qenë një Sherif Muhammet... një mësues turk me emër imami. Ai e ka parë që unë po shkruaj poezi dhe më ka dhënë shumë përkrahje. Në klasën e gjashtë poezinë e parë e botova në Shkup në botimet “Sevinç”, në revistën “Sevinç” e botova. Në Prizren ndonjë revistë, gazetë apo diçka nuk botohej. Në fakt, askund në Kosovë nuk kishte botime në gjuhën turke. Kishte vetëm transmetime radiofonike, nuk kishte transmetime të shkruara, nuk kishte media të shkruara, kështu që ne drejtoheshim kah Shkupi. Në Shkup ishte revista “Sevinç” dhe unë dhe shokët e mi vazhdimisht dërgonim artikuj në këtë revistë.

Pas përfundimit të shkollës fillore, ku të regjistrohemi? Si te çdo i ri kjo pyetje na mundonte edhe neve dhe u regjistrova në gjimnaz. Mirëpo, në krye të javës së parë, dytë në gjimnaz erdhën mësime të reja, “A do të vinit në Shkollën Normale? Në Shkollën Normale po hapet një klasë në turqisht” kanë thënë. Dhe ne, gjysma e asaj klase, 10-15 veta shkuam nga gjimnazi në Shkollë Normale, dhe unë e mbarova Shkollën Normale.

**Anita Susuri:** Po njëherë dua të ju pyes diçka më shumë lidhur me fëmijërinë...

**Iskender Muzbeg:** Urdhëroni...

**Anita Susuri:** Ju keni shkuar në shkollën “Mustafa Bakia”. Ka qenë shkollë më e vjetër pastaj thatë që u hap shkolla e re...

**Iskender Muzbeg:** Po, mund të më pyesni edhe shqip.

**Anita Susuri:** *Kjo ma e vjetër* [flet shqip] si është dukur kjo shkollë?

**Iskender Muzbeg:** Ajo shkollë ka qenë një ndërtesë e vogël dy katëshe, në fakt ajo paska qenë një shtëpi e vjetër. Në atë shtëpi paskan qenë katër dhoma dhe ato katër dhoma kanë qenë shkolla jonë.

Katër klasë kanë qenë. Jepej mësim në shqip dhe turqisht. Mësimi zhvillohej paradite dhe pasdite. Domethënë, tetë klasë kemi qenë aty. Një, dy, tre, katër. Pastaj është ndërtuar një shkollë e madhe, u ndërtua shkolla “Mustafa Bakia”. Ajo shkollë natyrisht ishte një shkollë e madhe, një shkollë që i plotësonte të gjitha kushtet. E bërë në mënyrë bashkëkohore, ishte shkollë e ndërtuar në fillim të viteve të ‘60-ta. Prapë po kthehem te ajo e kaluara, kjo shkolla jonë ishte ashtu... diku në mes të Hoça mahallës, një ndërtesë dy katëshe.

**Anita Susuri:** *Qysh u organizu familja?* [flet shqip]

**Iskender Muzbeg:** E jona [e imja]?

**Anita Susuri:** Me çka është marrur nëna, babai? Çfarë punë kanë bërë?

**Iskender Muzbeg:** Patjetër, patjetër. Babai siç e përmenda më herët ka qenë hoxhë, ka qenë hoxhë i Ramazanit. Gjatë fëmijërisë sime, nga një muaj, një muaj të çdo viti, ai nuk ishte në shtëpi. Shkonte në fshatra të ndryshme, këto kanë qenë fshatra shqiptare dhe në ato fshatra punonte si hoxhë [ju ndihmonte] të faleshin. Jo në këmbim të parave, të gjithë jepnin ngapak grurë, tjetri misër i jepte dhe me ato thasë kthehej, kthehej nga Ramazani dhe ne në shtëpi bënim Bajram.

Nëna ka qenë amvise, nëna ka qenë amvise por ka ditur shumë bukur të qëndiste. Posaçërisht te ajo porosisnin qëndisje, e dini për dasma, qëndisje edhe për këmishë edhe për kokë në tashfez<sup>2</sup> bënte qëndisje. Më kujtohet, më së shumti te nëna porosisnin qëndisje me zymbyl dhe zambak të lëndinës. Ajo qëndiste. Eh... në shumë shtëpi kishte rrymë, në shtëpinë tonë ende rrymë nuk kishte dhe nëna me dritën e llampës [së vajgurit], kjo m’u kujtua tani, me llampë mbrëmjeve, ditën jo se kishte punë të shtëpisë, mbrëmjeve nën dritën e llampës qëndiste. Më vonë nëna ka filluar të bëj edhe thurje të pëlhurës. Thoshte se kishte një tezgjah<sup>3</sup> të madh dhe aty thurte pëlhura. Ato pëlhura i merrte një grua dhe i shiste nëpër pazar.

Shtëpia jonë nuk ishte e mbushur me njerëz, babai, nëna, motra dhe unë, katër vetë. Domethënë, në këtë familje janë lindur një vajzë dhe një djalë. Më parë në martesën e parë, babai i ka pasur shtatë djem, por fatkeqësisht të gjithë kanë vdekur kur kanë arritur deri në moshën shtatë vjeçare. Shtëpia jonë e kishte oborrin e madh, kalldërma ishte e bukur por kërkonte përkujdesje. Më kujtohet prapë nëna e cila çdo ditë i këpuste barishtat që rriteshin ndërmjet gurëve. Shtëpia jonë kishte një veçori tjetër, në shtëpinë tonë ishte një bunar, domethënë një pus. Aty... sepse në shtëpi nuk kishte çeshme në atë kohë. Cilado shtëpi që kishte bunar, a një pus, ajo shtëpi ka qenë shtëpi me fat. Ka pasur një bunar në shtëpinë tonë, dhe ende është ai bunar dhe ka ujë, ka ujë shumë të mirë.

**Anita Susuri:** A jetoni ende në atë shtëpi?

<sup>2</sup> Kapelë e vogël tradicionale me qëndisje.

<sup>3</sup> Vegël prej druri ose makinë mekanike që përdoret për të endur pëlhurë, shtof, qilima etj.; vegjë, avlëmend.

**Iskender Muzbeg:** Po, ende në atë vend jetoj.

**Anita Susuri:** Apo është shtëpi më e re?

**Iskender Muzbeg:** Sigurisht shtëpia, në shtëpinë tonë ishin dy objekte, siç ma ka spjeguar babai objekti ku kemi banuar është ndërtuar për shkak të martesës së gjyshit tim. Lartë ka qenë një dhomë, përpara një ballkon dhe ndër atë dhomën ka qenë një kuzhinë. Por, gjatë dimrit kuzhinën e përdornin edhe si dhomë, për shkak se ishte ftohtë [e përdornin] si dhomë. Unë jam lindur në muajt e dimrit, në muajin dhjetor, më 19 dhjetor, dhe si më ka treguar nëna jam lindur në atë kuzhinë. Këtë të vërtetë e kam shprehur edhe në poezitë e mia.

**Anita Susuri:** A ju kujtohet si e kanë kaluar kohën të rinjtë në atë kohë?

**Iskender Muzbeg:** Patjetër, patjetër. Prizreni, shadërvani e kishte këtë formë. Por rrugët tjera ishin dhë e pluhur, asfalt nuk kishte, por në disa vende kishte kalldërm pra gurë. Rrugët ishin mjaft të pluhurosura. Afër shtëpisë tonë ishte një shesh i madh në atë shesh në luanim me top, pra fëmijët, por na është marrë fryma nga pluhuri. Në mbrëmje është dashur t'i lajmë të paktën këmbët dhe fytyrën, duart, sepse edhe ashtu në shtëpi në atë kohë nuk kishte banjo e të tjera si sot. Në të kaluarën kishte hamamxhik<sup>4</sup> dhe ne i përdornim ato hamamxhika. Siç thashë, Prizreni ishte i vogël, por kishte një bukuri që nuk mund ta shihni tani. Çfarë kishte, kishte rrëke të vogla, ujë në çdo lagje.

Në Prizren ka qenë një intelektual i njohur që ka ndërruar jetë, Durmiş Celina. Këtë e përmend edhe Durmiş Celina kur shkruan për ujërat e Prizrenit. Pra Bristica, tani Lumbardhi, ujërat e Bistricës në hyrje të Prizrenit ndaheshin dhe ato ujëra kalonin shtëpi më shtëpi dhe në fund ato prapë lidheshin me lumin, rridhnin. Në shtëpinë e gjyshes, më kujtohet që uji nuk kalonte në shtëpinë tonë sepse shtëpia jonë është në Terzi Mahallë dhe Bylbylderesi [Lumi i bilbilit] është në një nivel më të lartë. Në shtëpinë e gjyshes, që ishte më në qendër, kishte një rrjedhë të tillë uji. Por në ato kohë, këto ujëra të rrjedhshëm nuk i ndotnin. Ky ka qenë rregull për të gjithë, pra uji që vinte tek ne ishte i pastër, i njëjti ujë që kaloi nga ne te fqinji do të mbetet i pastër.

Vetëm e di që tek gjyshja, pas drekës te gjyshja në atë ujë i lanin enët. Domethënë, aq i pastër saqë mund të laheshin edhe enët. Prizreni e kishte këtë bukuri, sigurisht, e dini, në Prizren kishte shumë artefakte historike. Xhami, teqe, këto ende ekzistojnë. Sigurisht disa prej tyre u rrënuan. Për shembull, më kujtohet se ishte një xhami e madhe ku tani është komuna jonë, u rrënuar, ose këtu përballë postës është vetëm një minare e xhamisë Arasta, pjesë të tjera të saj janë rrënuar. Pra, me kohë kjo ndodhi për shkak të mos kujdesit të njerëzve, nuk është mbrojtur. Megjithatë, sot në Prizren ka shumë monumente historike për t'u parë, vizituar, dhe për të mësuar rreth tyre.

<sup>4</sup> Turk.: *Hamam içik*, banjo e vogël brenda dhomës.

**Anita Susuri:** Filluat të më tregoni për Shkollën Normale...

**Iskender Muzbeg:** Po, tani në Shkollën Normale, viti 1963 dhe në atë kohë në gjimnaz kishte klasë në gjuhën turke, në Shkollën Normale nuk kishte klasë në gjuhën turke. Stafi për arsimin turk këtu është siguruar nga Shkolla Normale në Shkup. Por me kalimin e kohës, me zhvillimin social, politik dhe kulturor, u lind nevoja që edhe këtu të hapeshin paralele turke dhe siç sapo e theksova, filluam arsimin turk në Shkollën Normale. Kush ishin mësuesit tanë që na mësuan turqisht? Për shembull, ishte një Ömer Mısırlı i cili jepte mësim në turqisht. Mësim rreth gjeografisë na jepte një profesor me emrin Adnan Morina. Histori na jepte Malih Osi.

Kishim mësues, mësimdhënës të cilët e kuptonin turqishten, por nuk mund ta ligjeronin në gjuhën turke. Ata silleshin me një tolerancë, ata neve na shpjegonin mësimin, por ne për notë, për notë kur pyteshim mund të shpjegonim në turqisht. Për shembull, ka qenë një Zekeriya Sofi, pra këta ishin mësimdhënës shqiptarë. Abdullah Shykriu na jepte biologji, por në kohën kur na pyeste ne atij i jepnim përgjigje në turqisht, flisnim, e kështu me rradhë.

**Anita Susuri:** Në ato vite sa keni qenë i ri ku e keni kaluar kohën?

**Iskender Muzbeg:** Po tashi, në atë kohë në Shkollën Normale, si në të gjitha shkollat, kishte aktivitete jashtëshkollore. Me fjalë të tjera, pas orës së mësimin kishte aktivitete të ndryshme, aktivitete të ndryshme letrare dhe aktivitete të tjera, aktivitete muzikore, kori. Mësuesi ynë [Xheladin Kastrati](#) drejtonte korin, këngët korale dhe grupi i korit të shkollës sonë ishte i njohur në Jugosllavi si një grup shumë i rëndësishëm në atë kohë. Në shkollën tonë u botua një revistë shkollore lidhur me aktivitetet jashtëshkollore. “Vllaznimi”, dilte në tre gjuhë, “*Kardeşlik*”, “Vllaznimi”, “*Bratsvo*”, në tre gjuhë dhe me një teknikë shumë të thjeshtë që i themi me shaptilograf<sup>5</sup>, me atë teknikë të thjeshtë u shtyp dhe iu shpërnda studentëve. Unë kam punuar në atë revistë sepse e doja poezinë.

Jashtë revistës dhe jashtë shkollës kishte teatër në kuadër të aktiviteteve të poezisë. Kishte një teatër poezie dhe një teatër amator. Ata që ishin të prirur për teatër shkonin atje, këtu ka qenë një artiste shumë e rëndësishme e teatrit, Hüda Leskovçali që tani më është e ndjerë. Në historinë e kulturës së Prizrenit ka një vend të rëndësishëm, ajo i përgadiste shfaqjet për teatër. Në shfaqjet teatrale aty kishte edhe drama shqipe, edhe drama serbe edhe drama turke dhe ishte një aktivitet shumë i pasur. Për këtë arsye, në mesin e viteve të ‘60-ta për shkak të këtij teatri në Prizren ka filluar të mbahet një festival.

Festivali i mbrëmjeve të vëllazërisë, dhe grupe teatrore, grupe teatrore amatore nga të gjitha republikat dhe rajonet autonome të Jugosllavisë vinin aty çdo vit dhe tërheqnin vëmendje të madhe në Prizren. Unë sa isha në shkollë kam punuar edhe në shoqatën “Doğru Yol” [trq.: Rruga e drejtë]. Fillimisht në shoqatën “Doğru Yol” më kanë thirrur të punoj si moderator i programit. Tani po më

<sup>5</sup> Makinë e posaçme që shërben për të riprodhuar në shumë kopje një shkrim të shtypur më parë në një letër dylli ose në një fletë të hollë alumini.

kujtohet drejtori i “Doğru Yol” më patë thënë, “Flokët rregulloji pak dhe eja, kemi një program” dhe unë në atë kohë tani ku është Kinemaja Punëtori, aty ka qenë një koncert dhe unë për herë të parë i jam bashkëngjitur “Doğru Yol-it” në atë koncert si moderator, spiker [Eng.: *speaker*] siç thoshim atëherë. Më vonë, në vitin 1968 themelua degën e letërsisë në shoqatën “Doğru Yol”.

Në fakt, në shoqatën “Doğru Yol”, e cila u themelua në vitin 1951, kishte një grup letrar, por ky grup u bë pasiv me kohë, njerëzit u shpartalluan dhe shkuan nëpër vende të ndryshme dhe në vitin ‘67 deshëm ta krijojmë një frymë të re dhe e kemi themeluar degën e letërsisë. Aty u zgjodha sërish kryetar, disa vite organizonim orë letrare herë me muzikë, herë organizonim vetëm orë letrare dhe tani fatkeqësisht nuk ka shumë interes për letërsinë në atë kohë. Për shembull, çdo orë letrare e frekuentonin të paktën njëqind të rinj dhe i lexonin poezitë dhe prozat e tyre. Me fjalë të tjera, Prizreni po zhvillohej në një mozaik kulturor me shqiptarë, serbë, turq, boshnjakë, romë e me të gjithë së bashku.

**Anita Susuri:** *A keni dal n’qytet, a keni shëtir n’korzo qysh ka qenë kjo barabart me jetën kulturore?* [flet shqip]

**İskender Muzbeg:** Po, kështu le të themi kishte koncert apo teatër, në ditën e koncertit në Prizren ishte një gjallëri e veçantë. Të gjithë përgaditeshin se në mbrëmje kishte në Shtëpinë e Kulturës apo tani në kopshtin e Kinemasë Lumbardhi koncert, ndoshta një orë para kësaj [dilin] te Shadërvani sepse e dini që Shadërvani është qendra e Prizrenit. Fillimisht te Shadërvani në korzo bënin disa xhiro shëtisnin, pastaj shkohej në koncert. Jeta rinore nuk kalohej sikur tani nëpër kafene, madje në kur kemi qenë në Shkollën Normale, Hotel Theranda e kishte kafenenë, por nuk ka qenë shprehi të shkohet në kafene. Të gjitha aktivitetet i kalonim në korzo, në gara sportive, kishte klube pikturë dhe fotografie, aty e kalonim kohën dhe në shoqata. Prizreni kishte tre shoqata shumë të rëndësishme kulturore dhe artistike. “Agimi” është një shoqatë që më duket se është themeluar në vitin ‘44. Ka qenë një shoqatë “Budućnost” [Srb.: Ardhmëria], ishte gjithashtu shoqata e kulturës artistike turke “Doğru Yol”, e cila u themelua në vitin 1951.

**Anita Susuri:** Për fakultet keni shkuar në Prishtinë...

**İskender Muzbeg:** Po, pasi e kam përfunduar Shkollën Normale unë pastaj nuk kam punuar si mësimdhënë, kam dashur ta vazhdoj shkollimin por e kam zgjedhur juridikun. Jam regjistruar në Fakultetin Juridik në Prishtinë. Aty kemi filluar me ligjerata, mësimet i kisha në gjuhën serbe. Në fillim të muajit, ende duke u mësuar me Prishtinën, Prishtinën në thonjëza, Prishtina e asaj kohe ishte shumë më ndryshe nga Prishtina e sotme. Më kujtohet që përveç rrugës kryesore të gjitha rrugët tjera ishin me baltë, sigurisht që më vonë Prishtina u zhvillua shumë.

Në vitin 1968 u regjistrova në Fakultetin Juridik në Prishtinë, disa muaj më vonë, në prill të vitit 1969, në Prishtinë filloi të dilte gazeta Tan<sup>6</sup> dhe më ftuan në këtë gazetë. Në fakt është bërë një shpallje, një konkurs, kam marrë pjesë në atë konkurs dhe jam pranuar. Kështu filluam të përgatisim numrin e parë të Tan-it. Ishte Safet Breka nga Prishtina, ishte Enver Baki... unë isha nga Prizreni, ishte shoku im Bayram Ibrahim, i cili po ashtu ka mbaruar shkollën Normale, ai është poet dhe tani jeton në Prishtinë. Ishte Müberra Tune nga Mitrovica. Dhe ne katër-pesë veta kemi marrë vendim për botimin e Tan-it me lejen e organeve përkatëse dhe filluam të përgatisim numrin e parë.

Mbaj mend që i dhanë një vend Tan-it, ishte një vend komplet bosh. Dy tavolina erdhën me një kamion dhe ato i vendosëm diku. Makinë shkrimi nuk kishte, sepse e dini që gjuha turke i ka shkronjat ö dhe ü, janë shkronja më ndryshe. Nuk kishte makinë shkrimi [me këto shkronja]. Drejtori i Tan-it, Süleyman Brima e kishte një makinë shkrimi ai e solli, si dhe në atë hapjen e Tan-it një makinë shkrimi e kishte edhe Süreyya Yusuf.

Dhe në kështu filluam të punojmë me Tan-in, brenda një muaji e përgaditëm numrin e parë, pas përgatitjeve nga 1 prilli deri më 1 maj, doli numri i parë i Tan-it. Aty është shkrimi im në faqen e parë të numrit të parë. Sigurisht që atëherë isha i ri, tani kur i shikoj ata artikuj nuk më pëlqejnë shumë të gjithë, por atëherë artikujt ishin të tillë.

**Anita Susuri:** Lidhur me çka ishin?

**İskender Muzbeg:** Meqenëse artikulli i numrit të parë ishte në faqen e parë, ishte në lidhje me datën 1 maj. Sepse nga 1 prilli deri më 1 maj dhe titulli i atij shkrimi ishte 1 Maji. Pra, çfarë rëndësie ka 1 maji, çka është, dita e punëtorëve e kështu me radhë, pra për 1 Majin. Në të, duke qenë se nuk kishim revista tjera në gjuhën turke, i kushtonim shumë rëndësi faqeve të kulturës. Në faqet e kulturës kemi përfshirë tregime, poezi dhe lajme kulturore, si dhe kishim një faqe të veçantë për fëmijë. Ne kemi përfshirë poezi dhe tregime të shkruara nga fëmijët.

Me kalimin e kohës, kam punuar në Tan nga viti 1969 deri në 1974. Në të njëjtën kohë e mbarova edhe Fakultetin. Unë isha duke studiuar dhe Süleyman Brima, drejtori i Tan-it dhe redaktori i parë përgjegjës, në këtë mënyrë kontribuoi shumë në diplomimin tim nga Fakulteti. Sepse ishte një person tolerant që m'i krijoi kushtet që edhe të punoja edhe ta vazhdoja shkollimin. Edhe atë e kujtoj me respekt.

## Pjesa e Dytë

**Anita Susuri:** Ku jetonit?

---

<sup>6</sup> Tan, në përkthim ka kuptimin e agimit, si e tillë është gazeta e parë në gjuhën turke pas Luftës së Dytë Botërore, e cila filloi të botohej më 1 Maj, 1969, dhe u mbyll në vitin 1992.

**İskender Muzbeg:** Në Prishtinë... domethënë kur u regjistrova në fakultet na dhanë konvikte, por kishte dy lloje konviktesh: konvikte për studentët e vitit të dytë dhe të tretë dhe konvikte për studentët e vitit të parë. Sigurisht, sipas kushteve të atëhershme, nuk ishin aspak kushte të mira. Me këpucë shkonim deri te shtrati. Ishte një vend shumë i thjeshtë. Por kur nisa punë në Tan, disa muaj më vonë na dhanë një banesë në atë kohë. Ndanim katër dhoma të një banese me katër gazetarë dhe kushtet ishin shumë të përshtatshme për të punuar në atë kohë. Kështu që, fakultetin e mbarova në kohë.

**Anita Susuri:** Ku ishte kjo banesa?

**İskender Muzbeg:** Banesa ishte tek Tre Sheshirat apo diku këndeje përtej Fakultetit Filozofik. Në fakt atë banesë ia kishin dhënë drejtorit Süleyman Brima. Pasi që ai ishte në Prizren çdo ditë vinte e shkonte, atë banesë na dha neve dhe ne në atë banesë edhe mësonim, Bayram İbrahim ka qenë aty, pak më herët e përmenda, në atë banesë ka qenë edhe Altay Sürey, të cilin e kemi punësuar më vonë. Ne e kishim edhe një fotoreporter Sedat Shporta, ne të katërtit e përdornim nga një dhomë të asaj banese.

**Anita Susuri:** Si ishte të jetoje në Prishtinë në atë kohë?

**İskender Muzbeg:** Natyrisht, ne u përziem me njerëzit në Prishtinë, veçanërisht sepse ky ishte një zhvillim shumë i rëndësishëm për Tan-in. Me fjalë të tjera, në aspektin e kulturës turke dhe në kuadër të Tan-it, të rinjtë vinin çdo ditë në Tan, sillnin shkrime, sillnin lajme dhe ne i vizitonim shkollat. I vizitonim shkollat për të raportuar. Gjimnazin e Prishtinës, ka qenë shkolla “Meto Bajraktari” e Prishtinës si dhe “Vuk Karadžić” sot shkolla “Elena Gjika”. Në “Meto Bajraktari” si dhe në “Vuk Karadžić” kishte klasë turke, dhe ne si Tan kemi qenë në bashkëpunim të ngushtë si me mësuesit ashtu edhe me nxënësit. Organizonim orë letrare, i ftonim ata në Tan. Në këtë mënyrë jemi afruar edhe me prishtinasit.

**Anita Susuri:** Çfare reportazha keni bo? [flet shqip]

**İskender Muzbeg:** Meqenëse unë punoja në faqet e kulturës në atë kohë, më së shumti bënim raporte për problemet e arsimit, problemet e zhvillimit kulturor, gjendjen e punëtorëve në fabrika, zhvillimin shoqëror dhe kishim edhe një faqe për gratë. Müberra Tuna e përgadiste një faqe të veçantë, ajo gjithmonë bënte intervista me gra për tema të ndryshme dhe i publikonte këtu. Mes këtyre faqeve kulturore kishte edhe një faqe sportive. Safet Rekiç përgadiste faqen sportive. Me fjalë të tjera, Tan nuk ishte thjesht një gazetë lajmesh, ishte revista jonë e kulturës, revista jonë muzikore, madje kishim një kompozitor që bënte kompozime muzikore në atë kohë, Hüseyin Kazaz krijimtaria e të cilit vazhdon ende. Ai krijoi edhe këngë të ndryshme për fëmijë dhe ne u përpoqëm t'i ndihmonim nxënësit në këtë mënyrë duke i botuar në Tan.

**Anita Susuri:** *A keni shkru, për shembull edhe për Kino Rininë?* [flet shqip]

**Iskender Muzbeg:** Po, kishte edhe disa lajme për Kino Rininë, domethënë lajme kur vinin filmat por puna jonë më shumë ka qenë e lidhur me shoqatë. Ndër reportazhet që i kam bo të themi, ka qenë me Azem Shkrelin, i cili ka qenë drejtor i Teatrit Krahinor në atë kohë, Teatro Kombëtare, me të kemi bërë reportazh. Pastaj bënim me artista, me artistat e teatrit, kemi bërë reportazhe me aktorë profesional të teatrit. Qoftë shqiptarë, qoftë serbë, kuptohet teatër profesional turk nuk kishte. Nganjëherë kemi shikuar filma në Kino Rinija, por ndonjë reportazh i veçantë nuk më kujtohet.

**Anita Susuri:** Çfarë filma keni shikuar?

**Iskender Muzbeg:** Në atë kohë më shumë ka pasur filma ose nga lufta çlirimtare popullore ose filma që vinin nga Perëndimi gjithmonë me do gangstera me diçka, dhe në shumicën e rasteve këta ishin filma amerikan.

**Anita Susuri:** Western<sup>7</sup>?

**Iskender Muzbeg:** Po Western nga Perëndimi. Prapë mu kujtua në atë kohë, jo në kohën kur kam qenë në fakultet por po kthehem pak më mbrapa. Ne nuk e dinim anglishten, por qarkullonte një tekst dhe në atë tekst shkruaje një fjalë, dy, dhe i dërgoje në adresë postare artistëve të atyre filmave që vinin. Për shembull, në atë kohë ka qenë Gary Cooper, Burt Lancaster, kush ishte tjetër? Ne ju dërgonim atyre letra, dhe kërkonim fotografi me autogram, kërkonim fotografi me autogram. Tani më kujtohet nga Elizabeth Taylor dhe me postë pas një muaji, dy muajve në shtëpi na vinin fotografitë e tyre të nënshkruara.

**Anita Susuri:** Me të vërtetë apo?

**Iskender Muzbeg:** Me të vërtetë, shumë e çuditshme. Me të vërtetë fotografitë e tyre të nënshkruara [na vinin], as ata neve nuk na njihnin ne ata i njihnim por këtë letër dhe tekst i shkruante kush dëshironte. Aty sigurisht ka shkruar që shumë ju pëlqejmë kërkojmë një fotografi nga ju. Domethënë, ne i shkruanim pa ditur përmbajtjen e tyre.

**Anita Susuri:** Prishtina ishte ndryshe nga Prizreni ka qenë pak më qytet apo jo?

**Iskender Muzbeg:** Më e zhvilluar, po thua...

**Anita Susuri:** A ka qenë ashtu? Sipas juve si ka qenë?

---

<sup>7</sup> *Western* është një zhanër i filmit që trajton tema të periudhës së gjysmës së dytë të shekullit të XIX-të dhe në fillim të shekullit të XX në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Percepti popullor i zhanrit *western* është ai i një tregimi që për fokus ka jetën e një semi-nomadiku avanturier që zakonisht është kauboj ose njeri i armatosur.

**İskender Muzbeg:** Po sigurisht, Prishtina ka qenë një qendër administrative, aty kanë qenë edhe organet shtetërore sepse në atë kohë Kosova ishte krahinë autonome dhe kishte organe shtetërore dhe nëse e krahasojmë me Prizrenin Prishtina tashmë ishte kryeqytet dhe të gjitha aktivitetet po zhvilloheshin në Prishtinë. Prizreni ka qenë një kryeqytet kulturor, qendër e kulturës, kryeqytet jo por si një qendër e kulturës ka frymuar. Ndoshta dallimi mund të jetë këtu.

**Anita Susuri:** Vitet e '80 muj me thonë [flet shqip], të '80-tat ishin më shumë... si të them... ka qenë situata pak më e vështirë sepse '81-tën kanë fillu demonstratat [flet shqip]. Si kanë qenë për juve ato vite?

**İskender Muzbeg:** Tani, natyrisht, atëherë nuk kam qenë në Prishtinë sepse kam mbaruar fakultetin në vitin 1974 dhe jam larguar nga Prishtina. Erdha në Prizren. Natyrisht, ato zhvillime politike po i mundonin njerëzit. Kishte disa situata shumë të vështira, por duke qenë se zakonisht më interesonte kultura, u fokusova në këto çështje. Edhe në Prishtinë, edhe në Prizren edhe në qytetet tjera '80-tat kanë qenë vite të trazuara, kanë qenë vite të turbullta, sigurisht që i mbaj mend.

**Anita Susuri:** Kur jeni kthyer në Prizren, çka keni bërë me çka jeni marrë?

**İskender Muzbeg:** Tani kur punoja në Prishtinë, në Tan, në Prizren... Fakultetin ende nuk e kam mbaruar, një person në Prizren me emrin Refet Kiser më tha një ditë, më tha, "Pse nuk vjen në Prizren? Je fëmijë i vetëm, nënën babanë e ke këtu, në Prishtinë... eja në Prizren unë jam drejtor i një ndërmarrje" tha, "eja këtu si avokat". Unë i kam thënë që ende nuk e kam përfunduar fakultetin. "Por ti eja se kemi nevojë" e të tjera. Dhe kështu erdha në Prizren pa mbaruar fakultetin, pa marrë diplomën.

Fillova të punoj si jurist në kompaninë "Universal" në Prizren. Një vit më vonë u transferova në komunë, në Komunën e Prizrenit. E në Komunën e Prizrenit në atë kohë edhe juridikun e kisha kryer edhe provimin për avokaturë. Kam punuar si avokat publik në Komunën e Prizrenit. *Avokati publik* [flet shqip]. Jo i popullit, tjetër është avokati publik. Ky institucion i avokatit publik mbron pronën e komunës dhe përfaqëson komunën në gjykata, duke mbrojtur të drejtat e komunës. Kam punuar në këtë detyrë për 13 vjet, pra kam punuar si avokat publik.

**Anita Susuri:** Çka u kon diçka ma interesant që ka ndodhë, ndonjë rast? [flet shqip]

**İskender Muzbeg:** Lidhur me këtë avokaturën a?

**Anita Susuri:** Po.

**İskender Muzbeg:** Tash, për shembull Lumbardhi... Lumbardhi mbaj mend në atë kohë, kur unë punoja si avokat, ishin ish-pronarët që donin ta kthenin Lumbardhin, ishin ish-pronarët e këtyre

lokaleve dhe kishin bërë një sërë padish, por nuk e di saktësisht se si ato padi përfunduan. Një tjetër ngjarje pse e paditën komunën. Për shembull, në Has, Hasi ishte pa ujë, s'kishte ujë, për të gjetur ujë në Has e kanë sjellë një ndërmarrje nga Kroacia e cila kishte hulumtuar, hulumtuar, por ujë nuk kishte gjetur dhe pasi që ujë nuk kanë gjetur atyre as para nuk ju kishin dhënë. Me këtë rast e kanë paditur komunën dhe unë si avokat i kam mbrojtur të drejtat e komunës. Mbaj mend që e zgjidhëm atë me një marrëveshje atëherë. Pra, detyra e këtij avokatit publik komunal është të mbrojë pronën komunale.

**Anita Susuri:** *Si ka vazhduar pastaj puna juaj?* [flet shqip]

**Iskender Muzbeg:** Unë pastaj kam kaluar në gjykatë. Fillova të punoj në gjykatë. Në gjykatë kam punuar diku dhjetë vite si gjykatës. Ndërsa pas luftës, pas luftës së vitit 1999 këtu në Prizren për Natasha Kandiç kam kryer punë në lidhje me të drejtat e njeriut në degën e Humanitarian Law Center në Prizren. Pasi punova atje për katër vite, kam hulumtuar edhe për temën e të drejtave të njeriut, veçanërisht në fshatrat e Komunës së Therandës, kemi punuar lidhur me personat e zhdukur në luftë. Shkoja nëpër shtëpi dhe bëja intervista, merrja informacione. Sigurisht që gjuhën shqipe nuk e flisja aq mirë. Por pas luftës nëpër ato shtëpi më kanë pritur shumë mirë. Edhe pse nuk flisja aq mirë shqip, shumë mirë na kanë pritur. Ata na jepnin gjithmonë të gjithë informacionin që na nevojiteshin.

Unë i bëra 75 vjet. Kur kthehem në të kaluarën, sigurisht që çdo gjë e mbaj mend sikur të ishte dje, por megjithatë kanë kaluar shumë rrugëtime. Meqë ra fjala, jam entuziast i poezisë, poezitë e mia i kam botuar në revista e gazeta të ndryshme dhe i kam botuar edhe si libër. Për shembull, libri im i parë me poezi, “Kaynak”, u botua në botimet “Sevinç” në vitin 1972 në Shkup. Pastaj në gazetën Tan u botua romani “Yanan Sevgiler” [Dashuritë e djegura]. Më vonë, në vitin 1974, u botua libri im me tregime me titullin “Sevil” në Tan. Dhe përsëri në vitin 1983, libri im me poezi u botua me titullin “E vërteta” në kuadër të botimeve “Birlik” në Shkup.

“Taşa Türküler” [Këngët e gurit] u botua në botimet “Birlik” në vitin 1987, “Dielli më ngroh mua” u botua në Tan në Prizren në vitin 1997, dhe prapë në Tan në vitin 1998 u botua libri me poezi i titulluar “Sülo”. Sylo është një figurë stilistike në poezitë e mia, përdoret si tip, që e mbanë gjallë ekzistencën tonë, që na jep kurajo. Ai është edhe drejtori im i parë në Tan, Süleyman Brima. Sylon e kam përdorur edhe në kuptimin e personit që e mban gjallë ekzistencën tonë. Nga këto librat ka dalë botimi i dytë i librit tim “Kaynak” sepse përdoret si tekst shkollor dhe si tekst shtesë në shkolla. Në të njëjtën mënyrë ka dalë botimi i dytë i librit “Taşa Türküler” pasi që mësohet nëpër shkolla.

Më lejoni t'ju them përsëri, më pëlqen puna ekipore. Sa i përket kontributit në arsimin në Kosovë, për shembull me Bedrettin Koron kemi përgatitur librat e Historisë për shkollat tona, Historia për klasën e pestë, Historia për klasën e gjashtë dhe Historia për klasën e shtatë. Përveç kësaj merrem edhe me përkthim, përkthime letrare, pra me përkthime kulturore. Për shembull, kam përkthyer nga poezia boshnjake dhe poezia shqipe dhe i kam botuar në gazetën Tan, në revistat Cevrem dhe Kuş këtu, në revistën Sesler në Shkup, dhe në shumë revista të tjera në Turqi.

Për shembull, në kuadër të përkthimeve nga poezia shqipe kam përkthyer në turqisht poezitë e Esad Mekulit, Faik Beqajt, Muhamet Kërveshit, Mirko Gashit, Çerkin Bytyqit, Selahadin Krasniqit e të tjerëve. Nga poezite rome [Kujtim Paçakun](#) dhe kam përkthyer e botuar poezi nga pesë-gjashtë persona të tjerë që mund t'i përmend. Kam përkthyer nga poezia boshnjake ashtu edhe nga ajo serbe. Ashtu, kam përkthyer edhe nga letërsia turke, letërsia turke e Kosovës dhe mostra poezish nga letërsia turke që u zhvillua në Maqedoni nga turqishtja në serbe dhe i botova në revista nëpër qendra të ndryshme kulturore të Jugosllavisë. Poezitë tona ishin të përfaqësuara edhe në serbisht edhe në gjuhën rome por edhe në italisht, në kuadër të Jugosllavisë në atë kohë.

**Anita Susuri:** Në rregull... me çka jeni marrë gjatë viteve të '90-ta, si kanë qenë këto vite për juve?

**Iskender Muzbeg:** Vitet e '90-ta ishin vite të shtypjes, ishin vite të shtypjes. Unë në atë kohë isha gjyqtar, por sigurisht kishte procedura të ndryshme të gjykimit. Kishte procedurë penale, për ata që kanë bërë krime, e që në atë kohë kishte shumë probleme të tilla, unë jam marr me procedura të trashëgimisë, *trashëgimia* [flet shqip], në këtë kontekst, mendoj se kam kontribuar shumë në rregullimin e këtyre marrëdhënieve të popullit tonë, përkatësisht në procedurën e trashëgimisë kam dhënë mjaft kontribut. Për shembull, dikush ka vdekur dhe prona e tij, trashëgimtarët kush janë merrnim vendim ne. Për mua ishte një çështje më vete, ishte një nga subjektet e fushës sime.

Në atë kohë kishte dalë një ligj, ligji për shitjen e banesave. Në të kaluarën fabrikat ju jepnin familjeve banesa për përdorim, kundrejt qirasë dhe në fillim të viteve të '90-ta u miratua një ligj që kush e përdor atë banesë ka të drejtë ta blejë. Mirë, por po them ka qenë gjendje e vështirë atëherë, për shembull ndërmarrja "Perllonka" në Prizren i lejonte serbët t'i blenin këto banesa. Në fabrika bëhej një marrëveshje me pak para mund ta bleje banesën në të cilën ke jetuar gjerë tani, por ata që nuk ishin serbë kishin problem, përse? Sepse po e njehta fabrikë, le të themi, ty nuk ta shiste banesën.

Dhe sipas ligjit, ata duhej të paraqiteshin në gjykatë dhe unë i trajtoja këto në gjykatë. Në të paktën 50 dosje kam pasur vendime që këta persona, qofshin shqiptarë apo turq, pra jo serbë, kanë të drejtë të blejnë banesat që kanë përdorur deri më tani. Dhe ndërmarrja nuk ia shiste, ata vinin në gjykatë, dhe unë merrja vendim dhe në fund ky vendim në fakt e ndryshonte kontratën, e ndryshonte kontratën dhe ata u bëheshin pronarë të atyre banesave me vendim të gjykatës. Pra, në ato situata të vështira, ishte mjaft e vështirë t'i kryeje këto punë.

Ndërmarrja ankohej menjëherë kundër vendimit tim. *Ankesa* [flet shqip]... dhe ai shkon në gjykatën më të lartë dhe e refuzojnë derisa të mbarojë, por unë kam përfunduar të paktën 50 çështje në këtë mënyrë. Domethënë, sigurisht që kanë qenë vite të vështira. Pas kësaj, në organizatën për të drejtat e njeriut që kam filluar të punoj pas luftës, bëja intervista me njerëz duke shqyrtuar gjërat dhe këto çështje. Pra, cilat të drejta u shkelën dhe si.

**Anita Susuri:** *A ka pasë edhe presion tjetër, se ka qenë vendimi rëndësishëm ky që e keni bo ju... [flet shqip]*

**İskender Muzbeg:** Patjetër që ka pasur... Për shembull mua më thoshin, “Eja të flasim” sepse në katin sipër ishte një gjykatë më e lartë. Shkoja, “Çka është kjo?” Thoshte, “Çfarë vendimi paske marrë?” Unë thoja, “Unë këtë vendim e kam dhënë në bazë të ligjit, çka thotë neni i këtij ligji, nëse një personi nuk i jepet leja për të blerë banesën, ai person vjen në gjykatë. Gjykata shikon kushtet, shikon kushtet, nëse i plotëson kushtet, nëse ka kontratë për ta përdorë me qira, nëse i jepet banesa, atëherë i plotëson kushtet” dhe une thoja kështu. Por, ata thoshin, “Ti e din si qëndrojnë gjërat”. “Unë e di, por unë jam njeri që e zbatoj ligjin”. Sigurisht, në këtë mënyrë i përfundoja këto dokumente dhe në fund askush nuk mund të thoshte asgjë. Ata njerëz, ata njerëz tani janë pronarë të atyre banesave.

**Anita Susuri:** *Ma herët deshta me pyet, po dolëm pak prej temës, si jeni njoftu ju [flet shqip], si jeni njoftuar me gruan tuaj?*

**İskender Muzbeg:** Në Shkollën Normale, në Shkollën Normale unë isha në klasën e katërt, bashkëshortja ime tani e ndjerë, ishte regjistruar në vitin e parë [të Shkollës Normale]. Aty jemi njoftuar ne dhe patjetër që rinia dhe njoftimet në atë kohë nuk ngjasonin me tash. Tani të rinjtë jetojnë në kushte shumë të ndryshme, takohen, njoftohen, kuptohet gjëja e parë ishte njoftimi, ndoshta me muaj pret se a do ta takosh dhe kështu me radhë. Por neve na është përshtatur biseda, kam pritur që ajo ta përfundoj shkollën, pastaj jemi martuar dhe në këtë martesë ne... Ah po, edhe ajo ka punuar si mësimdhënëse, deri kur ka vdekur ka punuar si mësimdhënëse. Nga kjo martesë ne kishim tre fëmijë, dy djem dhe një vajzë. Edhe fëmijët falë Allahut të gjithë e kanë përfunduar [fakultetin], i madhi Esini e ka përfunduar Fakultetin e Komunikimit në Universitetin e Ankarasë, edhe i vogli Bengi e ka përfunduar Fakultetin e Komunikimit në Universitetin e Ankarasë, vajza ime Belge ka studiuar këtu dhe është mësuese, ka mbaruar Fakultetin e Edukimit, tani punon si mësuese. Kam edhe nipër e mbesa, kështu vazhdon jeta.

**Anita Susuri:** Kohën e luftës qysh e keni kaluar, qysh kanë qenë ato vitet për juve?

**İskender Muzbeg:** Natyrisht, ata ishin muaj shumë të vështirë, situata dhe marrëdhëniet shoqërore-politike, të cilat filluan të vështirësoheshin në fillim të viteve ‘90, gradualisht arritën kulmin, dhuna u rrit dhe ja që u bë lufta. Luftën e kam kaluar me familjen në Prizren, ka pasur shumë vështirësi. Vështirësi kishte për të gjithë, për shembull dilnim herët në mëngjes për të blerë bukë. Vinte pak bukë, disa bukë dhe pastaj më nuk kishte bukë. Me fjalë të tjera, ka qenë edhe situata shumë e vështirë psikologjike dhe luftimet nuk kanë ndodhur në Prizren, por ka pasur konflikte përreth. Në mbrëmje dëgjonim të shtëna armësh dhe zhurma të tjera, të cilat krijojnë një frikë të madhe sidomos te fëmijët. Gjatë luftës, pra, lufta do të thotë rrëmujë, rrëmujë totale. Personi që e njihnit mirë deri dje, tani po tregonte fytyrën e msheftë të tij dhe mbeteshit të hutuar. A ndodhë edhe kjo? Por fatkeqësisht

ka pasur raste të tilla. Fatmirësisht nuk zgjati shumë, sepse po të kishte zgjatur edhe numri i vdekjeve do të ishte rritur dhe këto trauma do të ishin më të mëdha.

**Anita Susuri:** Pas luftës keni qenë në Prizren apo jo?

**Iskender Muzbeg:** Pas luftës, në Prizren Natasha Kandiç përmes organizatës saj ka bërë hulumtim lidhur me luftën dhe unë kam përgatitur raporte duke shkruar për atë çka ka ndodhur në luftë. Pastaj raportet tona u dërguan si në gjykatën e Hagës ashtu edhe në institucione të ndryshme në Evropë përmes organizatës së Natasha Kandiç, organizatës së saj.

**Anita Susuri:** *Këto punën e keni bo deri në pensionim a po?* [flet shqip]

**Iskender Muzbeg:** Jo, deri katër vjet, katër vjet më vonë u mbyll dega e asaj organizate në Prizren dhe unë fillova të vazhdoj punën si jurist. Duke punuar te Natasha Kandiç, më tha një ditë, “Ti i ke të gjitha kushtet për të qenë avokat, pse nuk e regjistron avokaturën?” Thashë, “Këtë nuk e kisha menduar”, më tha, “Në organizatën tonë mund të punosh si avokat”. Sepse në atë kohë, pas luftës, u inicuan disa gjykime kundër kriminelëve të luftës. Ishte në Gjilan, për shembull, unë shkova në Gjilan, dhe në Pejë, shkoje si monitorues, si vëzhgues dhe përgadisje raporte. Kështu që, mbaj mend që kishte një ngjarje rreth vrasjeve në Gjilan. Ishte një serb që kishte vrarë dy-tre vetë, dhe ekzistonte dosja e tij. Edhe në Pejë... Ah, edhe në Prizren ka qenë një i gjykuar lidhur me krime lufte, një burrë nga Rausa. Pra, unë shkoja në gjykata si vëzhgues dhe i shkruaja raportet e mija.

**Anita Susuri:** Si e kaloni kohën tani?

**Iskender Muzbeg:** Tani unë jam i pensionuar por ende punoj si avokat, tani punoj ngapak si avokat privat aq sa kam forcë. Por, qëllimi, dëshira ime është që të rregulloj pak më mirë këtë krijimtari që e kam bërë ndër vite, t’i përgatis poezitë e mia nga e para dhe të botoj libra të rinj. Mirëpo, kaloi siç thashë më herët kam nipa. Edhe me ata po merrem, kjo është një kënaqësi e veçantë.

**Anita Susuri:** *Nëse doni edhe diçka me shtu për fund...* [flet shqip].

**Iskender Muzbeg:** *Jo, faleminderit* [flet shqip].

**Anita Susuri:** *Faleminderit edhe juve shumë...* [flet shqip].